Me 1478 Sulltan Mehmeti II rrethon Shkodrën me mbi 100.000 ushtarë si kështjella e fundit e pa pushtuar deri atëkohë. Mbrojtja e Shkodrës zgjati për rreth 8 muaj nga vetëm një garnizon prej 1600 vetash shkodran dhe venedikas brenda në Kala pasi pjesa tjetër e popullsisë ishte larguar nga frika e pushtimit osman. Kjo qëndresë heroike e Shkodrës para Sulltan Mehmet fatihut u përshkrua nga historiani i parë shqiptar i asaj kohe Marin Barleti në Librin e tij "Rrethimi i Shkodrës" që u botua në Itali në vitin 1504. Në fund kështjella u dorëzua me kusht pas marrëveshjes së nënshkruar mes Venedikut dhe osmanëve më 25 Prill 1479. Gjate pushtimit qyteti dhe vetë Kalaja pësuan dëmtime të mëdha, të cilat u riparuan nga pushtuesit osman kryesisht në fortifikime dhe riparimin e dëmeve tjera të shkaktuara nga sulmet. Rimëkëmbja e qytetit bëri që në shek.XVII të bëhet qendër e Sanxhakut. Nga fundi i shek XVII fillimi i shek.XVIII fillon shtrirja e qytetit në fushën ku shtrihet sot. Deri nga fundi i shek.XVIII qendër e qytetit shërbente Xhamia e Plumbit ndërtuar nga Mehmet Pashë Plaku Bushatllij në vitin 1768. Lëvizja drejt fushës së krijuar nga Liqeni i Shkodrës ndodhi dhe për shkak se tashmë lumi Drin kishte ndryshuar shtratin e tij dhe Shkodra ishte kthyer në port lumor nëpërmjet lumit Buna. Në gjysmën e dytë të shek.XVIII Shkodra bëhet kryeqendër e Pashallëkut të familjes vendase Bushatllij që qeverisi Shkodrën në vitet 1757-1831 pallati i së cilës ndodhej në kështjellë, por që fatkeqsisht u dogj nga një zjarr i rënë aty në vitin 1858. Gjatë kësaj periudhe të sundimit të Bushatllijve, Shkodra mori një zhvillim të shpejtë. U ndërtua Pazari, i cili numëronte më shumë se 2500 dyqane dhe që ishte më i madhi në Ballkan. Në këtë kohë qyteti numëronte 50.000 banore. Deri në vitin 1858 pallati ka shërbyer si banesë e Valiut të qytetit. Bushatllijtë vunë dorë edhe në Kala kryesisht në kulla mbrojtëse dhe vrojtimi siç është ajo në jug-perëndim të kështjellës e ndërtuar për të kontrolluar rrugën nga Lezha dhe zonen ku bashkohet lumi Drin me Bunën. Kjo kullë është e paisur dhe me një dalje të maskuar në raste rrethimi nga Kalaja. Bushatllijve i përket dhe muri që ndan pothuajse në mes kështjellën i paisur dhe me portë hyrëse me qemer të trefisht. Përfundimisht Kalaja e Rozafës - Shkodrës u braktis në vitin 1865 kur administrata e qytetit u shpërngul për në qendrën ku është dhe sot dhe mëpastaj Kalaja shërbeu vetëm si qendër e garnizonit osman.




Rozafa, Toponimia e Rozafës

Kështjella njihet me emrin Rozafa në periudhën e mesjetës, gjatë së cilës u pushtua herë nga sllavët dhe herë nga bizantinët. Marin Barleti, në shek. XV - në veprën e tij, "Rrethimi i Shkodrës" tregon se: "Na patën rënë në dorë disa shkrime... Ishin shkruar aty në gjuhën popullore se një farë Roza me motrën e vet, të quajtur Fa, qenë themelueset e para të Shkodrës e prandaj fortesa e saj quhet Rozafa". Ekziston një variant i baladës, në të cilin gjithçka kryhet nga Roza e Fa sipas veprimeve dhe situatave të baladës së murimit. Por Barleti nuk i përmend situatat dhe nuk e përmend flijimin. Emri i Kështjellës është i lidhur me legjendën e murimit. E ndërtuar gjatë mbretërisë Ilire, përfaqsohet nga një legjendë që tregon mbajtjen e një premtimi, të Besës legjendare. Rozafa, nusja e më të voglit ndër tre vëllezër (baca Gjergj), u muros e gjallë në themelet e kalasë,- si këshillë nga një plak, tregon legjenda,- si një sakrificë për të ndalur përgjithnjë syrin e keq që shkatrronte muret për çdo natë. Uji gëlqeror që kalon ndër muret e kalasë lidhet, në fantazinë e folklorit, me qumështin e gjirit të Rozafës, kërkesa e së cilës si akord për të pranuar sakrificën ishte lënja e anës së djathtë të trupit «sýnin e djathtë që t'shoh birin t'em, krahun e djathtë qi t'a mbáj, gjinin e djathtë qi t'a ushqej, kâmben e djathtë qi m'e përkûnd djepin» që të kujdesej për të birin e sapolindur. Për toponiminë, balada, sidomos ajo që flet për kalanë e Shkodrës, jep një sërë territoresh. Ato gërshetohen me territorin rreth kështjellës së Rozafatit: Kazenë (kodra matanë Bunës ku ndodhet kisha e Sh.Mari

Magdalenës), Maldunus ose Valdunus (kodra mbi të cilën ngrihet Rozafati), Zarufe (kodra e Pashës). Të tria këto ekzistojnë edhe sot.

Struktura e Kalasë së Rozafë, Sipërfaqja e brendshme e kalasë ndahet nga muret e tre oborreve, me porta mes tyre. Oborri i tretë, i cili është më i vogël se të tjerët, ndodhet në pjesën më të lartë të kodrës. Në muret dalës të tij, ka të dalura drejtkëndëshe që zëvendësojnë kullat, ndërsa në murin e jashtëm, kullat janë më të dendura. Brenda kështjellës ka disa ambiente që lidhen me një kullë rrethore, një depo si dhe një godinë trekatëshe të kohës veneciane. Oborri i dytë zë pjesën qendrore dhe më të madhe të kalasë duke u ndarë nga oborri i parë me një mur tërthor pa kulla. Brenda tij ndodhen katër depozita për grumbullimet e ujit, katërkëndëshe të mbuluara me qemerë, prej të cilave uji merrej përmes grykave të puseve rrethore. Aty ruhen dhe një depo, një burg si dhe një kishë e kthyer më vonë në xhami. Oborri i parë komunikon me hyrjen kryesore të kalasë, para së cilës në vitet 1407-1416, u ndërtua një oborr i fortifikuar, një sistem paramuresh me kthesa të mprehta që zënë pjesën lindore të kalasë. Oborri përbëhet nga një kullë katërkëndëshe me gjerësi 10 metra dhe gjatësi 20 metra, kati i poshtëm i së cilës është i mbuluar me një qemer cilindrik përshkues që nga hyrja. Në dy anët e kësaj galerie ndodhen nga katër nike të mbuluara me qemer cilindrik.



Struktura skematike e Kalasë së Rozafës

Kati i dytë i kullës përfundon me një tarracë pjesërisht të mbuluar me çati, ndërsa pjesa tjetër ishte rrethuar me një parapet të pajisur me bedena dhe frëngji. Porta mbulohet me një hark sektorial të dyfishtë prej gurësh të punuar, mbi të cilin ndodhet një hark shkarkues gjysmë rrethor prej dy rrahtë gurësh të punuar, brenda fushës së të cilit është gdhendur si dekoracion një hark majë lundre me një formë spirance në kulmin e saj. Pas korridorit të kullës ndodhet një oborr i vogël katërkëndësh i kufizuar djathtas me mur. Këtu ndodhen shkallët për në shtegun e rojës. Përballë murit ndodhet porta kryesore e kështjellës dhe anash saj një portë e vogël. Për të hyrë në brendësi të kalasë, duhet të kalosh një korridor në formë L-je, të mbuluar me qemer cilindrik, fundi i të cilit mbyllet nga një portë e dytë. Një pjesë e qemerit është me tulla dhe në kyçin e tij ndodhet një vrimë drejtkëndëshe 40 x 55 cm që shërbente për të hedhur lëndë djegëse të nxehtë mbi kundërshtarin.

Përveç hyrjes kryesore, kalaja ka edhe disa hyrje të vogla që shërbenin për manovrimin e forcave në raste rrethimi apo si dalje sekrete. Njëra prej tyre, e ndodhur në rrëzë të paramurit lindor, ruhet akoma dhe ka një thellësi rreth 4 metra. Venecianët kanë kryer punime të veshjes së kullave dhe nën këto veshje ka ndërtime që i përkasin periudhës kur sundonin Balshajt. Gjatë riparimeve, anës së jashtme të mureve, iu është dhënë pjerrësi në formë skarpati që arrin deri në gjysmën e lartësisë së tyre.

Nga ana perëndimore e kalasë, sipërfaqe të pjerrëta të kodrës shkëmbore janë veshur me gurë të skuadruar. Aty ku veshja e mureve nuk është bërë, dallohen teknikat e vjetra me vendosje copa tullash mes gurëve, ndërsa harqet e dritareve dhe frëngjive janë punuar me tulla të rrethuara me bordurë. Kullat kanë forma rrethore dhe katërkëndëshe, në një lartësi 12-16 metra. Ato janë më të larta në anën e jashtme dhe përbëhen nga një kat i mbuluar me qemer dhe tarraca me parapet të dhëmbëzuar. Hyrja në ambientet e kullave bëhej përmes një porte të hapur në murin e tyre të prapmë, ndërsa lidhja me tarracën bëhej përmes shkallësh të brendshme që përfundonin në tarracë nëpër një baxho katrore me mur anash, ose me shkallë të jashtme guri.

Kalaja ka një pozicion të fuqishëm strategjik duke kontrolluar të gjithë territorin e gjërë përreth. Ajo ishte në

qendër të një sistemi të plotë mbrojtjeje, që përbëhej prej një vargu kështjellash të tjera më të vogla si ajo e Ballezës, Drishit, Danjës, Shurdhahut etj.

Muzeu i Kështjellës Rozafa

Muzeu i Kështjellës - Rozafa ngrihet në oborrin e tretë të Kalasë "Rozafa" në një ndërtesë të shek. XV që njihet me emrin "Kapitaneria", rezidenca e Kapitanit (sundimtarit Venedikas). Dallohet se është ndërtesë me karakter ushtarak nga trashësia e mureve (2.1m. në bazë dhe 1.9 m. në katin e tretë) për t'i bërë ballë goditjeve direkte të artilerisë, nga dritaret e vogla që kanë shërbyer si frëngji (ato të katit të dytë), nga dalja e fshehtë, hyrja e së cilës është në katin e parë dhe nga qemeri masiv prej guri që e mbulon, i cili shërbente për ta mbrojtur nga predhat zjarrvënëse. Në Muze me anë dokumentash e objekteve të ekspozuara paraqitet Kalaja në rrjedhën e historisë e lidhur ngusht kjo edhe me historinë e qytetit. Përballë derës kryesore është një bazoreliev në gips, i autorit shkodran Skënder Kraja. Vepra paraqet legjendën e themelimit të Kalasë, sipas së cilës gruaja e re (Rozafa) vetëfliqohet që të qëndrojnë muret mbrojtëse të qytetit.

Kalaja e Rozafës - monument kulture

Kalaja është shpallur monument kulture në vitin 1948 dhe mbrohet nga shteti. Për herë të parë restaurimi i Kalasë së Rozafës ka filluar në vitin 1971, kryesisht në hyrje të kështjellës. Pastaj është restauruar Kisha e Shën Stefanit brenda në Kala, ndërtimi i së cilës daton aty nga fundi i shek.XIII dhe që me pushtimin osman ajo kthehet në xhami (në vitin 1479). Nga fundi i viteve 80-të kemi një fazë të dytë restaurimesh në Kala. Objekte të vizitueshme brenda kalasë janë katedralja e shek. XIII, e cila pas pushtimit osman u kthye në xhami, çisternat e ujit të shek XV, kullat si dhe Muzeu i Rozafës.

Në maj - qershor 2012, në Kalanë Rozafa janë zbuluar varre të shek.XVI

Në maj - qershor të këtij viti, një ekspeditë shqiptaro-polake ka bërë zbulimin e varreve që i përkasin shekullit XVI. Këto zbulime arkeologjike në kalanë Rozafa në Shkodër dëshmojnë qartë kulturën e lashtë ilire të zonës ku ajo ndodhet. Gërmimet arkeologjike në këtë zonë kanë filluar pas 30 vjet ndërprerjesh. Ato janë përqendruar në dy zona, atë të Tabakëve poshtë Kalasë, buzë lumit Drin dhe sipër në oborret e Kalasë së lashtë të qytetit verior. "Aktualisht jemi akoma në punimet e periudhës së gjurmëve otomane, ndërkohë që në vazhdim do të zbresim më poshtë duke u ballafaquar me periudhat veneciane për të vijuar me ato mesjetare, antike, ilire, si dhe të periudhave të mëhershme që e kanë shoqëruar në vite këtë rajon", ka thënë arkeologu Saimir Shpuza, në një prononcim për mediet shqiptare. Drejtues i ekspeditës polake është arkeologu Prof. Piotr Dyczek, drejtor i Qendrës për kërkime në antikitet për Europen Juglindore në Universitetin e Varshavës në Poloni. Grupi i ekspeditës shqiptaro-polake ka qëndruar në këtë zonë deri më 6 qershor 2012. Për këto gërmime arkeologjike është nënshkruar një kontratë 5-vjeçare midis Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë, Parkut Arkeologjik të Shkodrës, Bashkisë së këtij qyteti, si dhe universitetit "Luigj Gurakuqi". Ky projekt do të mundësohet nga Ministria e Turizmit dhe Ambasada polake në Tiranë. Gërmimet e filluara mendohet se do të përfshijnë gjithë zonën përreth Kalasë Rozafa dhe zonën brenda saj.

Shkodra shtrihet për rreth 872.71 km²[32] në nyjën hidrografike me pranë liqenit me të njëjtin emër dhe lumenjtë Drin, Bunë dhe Kir në një ultësirë të "mbrojtur" nga liqeni, Alpet Shqiptare në lindje ku spikasin majat e Cukalit (1.722 m), Maranaj (1.576 m), Sheldisë (mali Sardonik i Barletit; për nga Shurdhahu) dhe Taraboshit (rreth 700 m) në perëndim dhe deti Adriatik. Në një rreze prej 45 km mund të arrihen ranishtet në Adriatik, shëtitjet e alpinizmi në Alpe, e kanotazhi nepër lumenj. Më 23 janar 1916 ushtria austro-hungareze hyri në Shkodër.



Nisi strukturimi i arkitekturës sipas kriterëve të artit islam, disa kisha u bënë xhami. Në hyrje të Pazarit ka pasë një Hamam të ndërtuar nga i quajturi Allaman begu me datë 1519, i njohur si *Hamami i Vjetër*. Pjetër Bogdani e përmend se në hyrje të hamamit kishte të shkruar në mermer me numra romakë (1470, 5 tetor).



Parada e Karnavaleve

Qyteti numëron rreth 100 000 banorë e shquhet për shumëllojshmërinë në kahin urbanistik e arkitektonik, shtëpitë më të vjetra me 1 ose 2 kate kanë bahçe e oborre të gjelbërta e me lloj-lloj lulesh, rrugët janë të ngushta e dikur ishin me gur të kalitur (rrugë të ngushta e të vogla karakteristike, të emëruara nga familje që kanë dhënë kontribut për qytetin apo nga gojëdhëna. Ndërtimet më të vona të shek. XX ndikohen nga prirjet arkitektonik tradicionale, të racionalizimit italian e të realizmit socialist

Gjeografia. Shkodra është qendër e një hinterlandi të banuar në mënyrë të pandërprerë, ku janë gjetur gjurmë të paleolitit (gurit të vjetër) të mesëm, ndërsa që nga neoliti (guri i ri) gjurmimet kanë zbuluar vazhdimësi jetese që vjen deri në ditët tona. Objektet e gjetura gjenden në muzeumin e qytetit, në atë të Tiranës dhe në muzetë e Evropës. Kjo sepse zona ka një kombinim të rrallë faktorësh fizikë për jetesë.

Rrëzë kodrave të Tepes, në anën jugore të qytetit të sotëm, materialet arkeologjike fillojnë nga Bronxi i hershëm (2000 p.e.r). Në shekullin V – IV p.e.r. filloi ndërtimi i kalasë me gurë ciklopikë të puthitur pa llaç. Kalaja është e vendosur mbi një kodër në hyrje të qytetit në një lartësi 130 m. Shtrirja në mes të një relievi fushor, kodrinor, paramalor dhe malor, afërsia me Detin Adriatik dhe liqenin e Shkodrës kanë përcaktuar edhe klimën e saj, një klimë mesdhetare me dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare në vit variojnë nga 11,8 °C deri në 14,0 °C. Temperatura në Janar nga 0,9 °C deri në 6 °C. Në dimër fryn era e murrllanit (erë lokale), e ftohtë, e fortë dhe e thatë, ndërsa në fund të vjeshtës fryn era e shirokut, që shoqërohet me reshje dhe fryrjen e lumenjve. Sasia e reshjeve në këtë qytet është e madhe. Mesatarisht aty bie 2500 mm shi në vit, pra një nga zonat më të lagështa të Shqipërisë. Muaji me i ftohtë i vitit është muaji janar, ndërsa muaji me i nxehtë i vitit është muaji korrik. Reshjet e dëborës bien rralle, ndërsa ngricat shënohen zakonisht në fundin e vitit.

Demografia. Prania ortodokse ishte një ndikim historik prej sundimit bizantin dhe më pas feudalëve serbë të Zetës, të cilët i përkitnin pas Skizmës. Me vdekjen e Stefan Nemanjiqit, ndikimi venedikas bëhet më i dukshëm dhe Argjipeshkvia e Tivarit u bë mbështetje për hapjen e katolicizmit.

Pas pushtimit osman elementit i krishterë lejohej të banonin në vendbanime larg kështjellës[35], kësodore qyteti nuk do të ishte më seli ipeshkvnore dhe arqipeshkvnore metropolitane deri më 15 mars 1867 kur u emërua argjipeshkv Karl Pooten. Deri në kohën e emërimit të tij, selia e arqipeshkvisë ishte në Tivar. Në vitin 1478 kur Mehmeti II rrethoi qytetin, në kështjellë qenë dy fretën françeskanë, njëri prej tyre arbër, P. Pali nga Matja[21]. Me pushtimin në qytet u përhap Islami, së pari prej pranisë ushtarake dhe më pas nga popullata e konvertuar

Qyteti ka përshfaqur që me pragun e periudhës së Bushatllinjve një hapje kundrejt larmisë fetare[35]. Por në rastin e prishjes së Oxhakut të Jeniçerëve, çoi në dëbimin e bektashinjve nga qyteti, gjë që sipas Dela Rokës ka shtyrë

drejt Islamit sunit[36]. Sidoqoftë ky tarikat ishte ndër të parat mënyra të avitjes së Islamit në qytet, duke qenë se jeniçerët ishin trupë e bekuar nga Haxhi Bektashi. Sipas studjuesit të zellshëm të historisë së qytetit, Hamdi Bushatit, mendohet se në fillim të sundimit të Mustafa pashë Shkodrës ka pasur afro 70 teqe dervishësh të tarikateve të ndryshme, që ndiqeshin edhe prej parisë feudale. Tarikatet që kanë qenë dhe janë ende të përhapura në qytet janë bektashitë, nakshibenditë, rifaitë dhe tixhanitë. Rinisja e hapjes së tyre pas dëbimit të madh, qe vepër e Sheh Ahmet Shkodrës.

Më 1846 u vendos në qytet Urdhri Jezuit, për të themeluar një qendër të vazhdueshme, duke kontribuar në ngritjen kulturore të qytetit me institucionet arsimore, kongregacionet bamirëse. Urdhri Françeskan kishte një prani të kryehershme në viset përreth Shkodrës, duke pasuar benediktinët në shek. XIII, por në qytetin e Shkodrës u ngulitën për herë të parë më 1861 me nisjen e ndërtimit të Kuvendit të Gjuhadolit.

Ortodoksët e qytetit, sipas thënies lokale s'bajnë ma se 100 shpi, nuk kanë lidhje me ortodoksët mesjetarë dhe relativisht janë të përbërë prej origjinave kuço-vllehë ose gogë, shqiptarë, serbo-malazezë, grekë e armenë. Sipas njërit burim të H. Bushatit, paraardhësit e ortodoksëve shqiptarë kanë ardhur nga Vilajeti i Kosovës dhe i Manastirit, veçanërisht nga Struga (familja Banushi, Pistoli). Ortodoksët me prejardhje joshqiptare janë shqiptarizuar me shekuj.

Shkodra përmendej si qendra e fetarizmit islam, ashtu dhe atij kristian, në Shqipëri, gjithashtu dhe qendra e kulturës qytetare. Më poshtë janë disa nga objektet më me rëndësi dhe që janë të vizitueshme.



Xhamia Ebu Bekër



Kisha Françeskane



Buna e Rozafa



Xhamia në Parrucë



Buna



Shtëpia e Oso Kukës, sot Muzeu i qytetit



Kalaja e parë nga Dajlanet në Zusë



Moloja

Kulla e Gjon Markagjonit



Monumentet



Kafja e madhe, Foto Marubi



RR. Kol Idromeno



Ura mbi Bunë



Drini , derdhja në Bunë



Prejardhja e emrit

Si emër është hasur qysh në lashtësi në formën *Skodra* (lat.: Scodra; greq. e vj.: Σκόδρα), gjithashtu në rasën gjinore të greqishtes Σκοδρινῶν ('e Skodrinëve') gjetur ndër monedha prej shek. II p.K. Presbyter Diocleas shkruan *Scodaris*, si mbiemër *Scodrensis*.

Prej vitit 1287 shihet forma *Scutarum* (mb. *Scutarensis*)^[3], emri u përshtat në italishte Scutari, formë e cila që mjaft e përhapur në anglishte deri në shek. XX^[4]. Forma e moçme serbe ka qenë *Skëdër*, me dy gjysmë-zanore. Forma në serbo-kroatishte *Skadar* (Скадар) shihet që nga mbarimi i shel. XIV^[3], e në turqishten osmane, gjithashtu në turqishten e sotme *İşkodra*.

Përgjatë sundimit osman është quajtur edhe *Işkenderiyye* nga *Işkender* duke pandehur se banorët e këtij qyteti ishin të bijtë e Aleksandrit të Madh (i quajtur Skënder në traditën myslimane) për nga trimëria që shfaqnin në beteja, nga ku Barleti nxjerr tezën se Shkodrën mund ta ketë themeluar Aleksandri i Madh, që qarkullonte edhe ndonjë shekull më vonë tek e shkruan udhëpërshkuesi osman Evlija Çelebi.

Përzhvillimi i emrit prej trajtës së vjetër në të tanishmen mbahet nga Çabej^[5] dhe Demiraj^[6] si një vijim i natyrshëm i gjuhës shqipe.

Arkitektura dhe tradita e bibliotekave

Studjuesi shqiptaro-kroat Aleksandër Stipçević në “Historinë e librit” shënon se në Iliri ka pasur 72 biblioteka dhe disa syresh kanë qenë edhe në Shkodër. Nga ana tjetër, në veprën e Marin Barletit, “Rrethimi i Shkodrës” thuhet se ka pasur anale të shkruara në gjuhën e popullit.^[41] Sipas të dhënave të Daniele Farlatit në “*Illyricum Sacrum*”, “qendra të rëndësishme të administratës e kulturës me arkiva e biblioteka të famshme kanë qenë arqipeshkëvitë e *Durrësit, Tivarit, Shkodrës e Shkupit*”. Madje Shkodra njihet edhe si bërthama e parë e bibliotekave publike në Shqipëri. Në vitin 1917, u hap e para bibliotekë shtetërore e quajtur Biblioteka e Komisis Letrare, që u drejtua nga Hilë Mosi. Bibliotekë e cila iu bashkua fondit të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë

Sipas rendit kronologjik bibliotekat e Shkodrës i përkasin viteve: 1683, Biblioteka Bogdani, 1750 Biblioteka e Myftiut të Tabakëve apo Këllyçit, e cila fatkeqësisht nuk ekziston më, sepse u dogj, 1834 biblioteka e Vakëfit shumë të rëndësishme për fondin e dorëshkrimeve në gjuhët orientale, në 1858 biblioteka e Etërve Jezuitë, 1875 biblioteka e Françeskanëve, 1899 e Shoqërisë “Bashkimi”, 1901 e Shoqërisë “Agimi”, 1911 e Klubit “Gjuha jonë”, në vitin 1917 e “Komisisë letrare”, 1919 e Shoqërisë Vllaznia

Historia

Shkodra është një nga qytetet më të lashta dhe më të mëdha të Shqipërisë, qendër e rëndësishme ekonomike dhe kulturore. Shtrihet në skajin jugor të Ultesirës së Mbishkodrës pranë Liqenit të Shkodrës, në lartësi 16 m., ndërmjet lumenjve Drin e Buna, malit të Taraboshit dhe kështjellës së Rozafes.

Shkodra është themeluar aty nga shek. IV p.k. në kodrat përreth Kështjellës së Shkodrës. Ishte qendër e fisit ilir të Labeatëve dhe gjatë sundimit të Gentit (181-168 p.k.) u bë kryeqendra e shtetit ilir. Të kësaj periudhe janë monedhat e prera me emrin e qytetit. U pushtua nga romakët më 168 p.k. Neper Shkodër kalonte rruga e njohur tregtare-ushtarake që vinte nga veriu dhe neper luginën e Drinit kalonte në Kosovë e më tej. Më 1040 u pushtua nga serbët dhe ishte kryeqendra e Zetes. Gjatë shek. XIV u bë qendër e rëndësishme komune autonome me institucione të zhvilluara dhe me pas qendër e feudaleve Balshaj. Më 1936 u pushtua nga venedikasit, sundimi i të cilëve u ndërpre nga një varg kryengritjesh të popullsisë. Shkodra u bëri balle dy rrethimeve osmane, më 1474 e 1478-79 dhe ra në duart e tyre pas një mbrojtje heroike që pati jehonë ndërkombëtare. Ishte vendlindja e humanistëve Marin Barleti e Marin Becikemi. Pas pushtimit popullsi u shpërngul, qyteti u rrenua sa y kthye në fshat. U rimëkemb dhe në shek. XVII arriti 1800 shtëpi. U bë qendër kryesore ekonomike e Shqipërisë së veriut dhe e sanxhakut të Shkodrës, Lulezuan zejtarite, punimi i armeve, i mendafshit, argjendaria etj.. U ndertuan shtëpi dykateshe prej guri me cardak, pazari, Ura e Mesit. Në shek. XVIII u bë qendra e pashallekut të Shkodrës nën sundimin e Bushatllinjve (1757-1831). Edhe pas rënies të pashallekut, banoret kanë bërë një varg kryengritjesh kundër pushtuesit osman (1833-1836, 1854, 1861-62, 1869).

Zhvillim të madh ekonomik arriti Shkodra nga mesi i shek. XIX. Më 1870 kishte 50.000 banorë. Përveç si qendër e vilajetit, ishte një e rëndësishme për gjithë Ballkanin perëndimor me 3500 dyqane. Më 1807-1808 ishte ndertuan bezisteni. Punoheshin pelhuret, veshjet kombëtare, lekuret, duhani, baruti etj. Që më 1718 ishin hapur agjensi konsullore të disa vendeve të huaja. Si port përdorej Oboti, por sodomos Ulqini dhe më vonë Shengjini. Më ndërhyrjen e fuqive të huaja në mesin e shek. XIX u themeluan seminari jezuit dhe kuvendi franceskan. Gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit Shkodra ishte vater e rëndësishme e levizjes kombëtare. Banoret më në luftimet për mbrojtjen e tokave shqiptare dhe nënshkruan boterisht në sheshin kryesor të qytetit protestat drejtuar fuqive të mëdha. Dega e Lidhjes për Shkodrën, që pati dhe garden e vet, ishte nga më veprueset dhe dha ndihmese për mbrojtjen e Plaves e Gucisë, të Hotit e Grudes dhe në luftën për Ulqinin. Ajo u shtyp e para me armë nga Porta e Lartë. Shkodra ka qenë në të periudhë gjithashtu edhe qendër e rëndësishme kulturore. Përmendet biblioteka e Bushatllinjve, për të cilën në vitet 40 të shek. XIX u ngrit ndërtesa, që shërbeu më pas si seli e degës së Lidhjes. U themeluan shoqëri letrare, kulturore e sportive, si shoqëria «Bashkimi» dhe «Agimi». U ngriten shtypshkronja, ku u botuan edhe të parat gazeta e revista brenda kufijve të Shqipërisë. Më 1878 u ngrit e para bande muzikore e vendit dhe në Shkodra nisi puna e fotografëve Marubi, nga e cila trashëgohet një fototeke shumë e pasur. Shkodra është vendlindja e Pashko Vases, Zef Jubanit, Luigj Gurakuqit, Filip Shiroka e mjaft shkrimtarëve të tjerë. Më 1905 u festua për herë të parë 1 Maji në Shqipëri. Shkodra gjatë Luftës Ballkanike dhe gjatë Luftës së I Botërore u bë për e synimeve grabitqare e Malit të Zi e Sërbisë. Populli i Shkodrës mbajti për shtatë muaj rrjesht qytetin kundër ushtrive rrethuese malazeze e serbe, të cilat hyjnë në qytet më 23.4.1913, me tradhëtinë e Esat Pashë Toptanit duke demtuar rëndë qytetin dhe duke djegur pazarin. Por ato u detyruan më 14.5.1913 të linin Shkodrën e cila në bazë të vendimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër ishte pjesë e Shqipërisë, por duke e vendosur në një administrim ndërkombëtar. Më shpërthimin e Luftës së I Botërore forcat malazeze perseri hyjnë më 27.6.1915 në Shkodër. Më 22.1.1916 qyteti u pushtua nga Austro-Hungaria dhe u bë qendra e tyre e pushtimit. Më mbarimin e luftës u vendos për kohësisht administrata ushtarake ndërkombëtare dhe më 11.3.1920 Shkodra u bashkua administrativisht me Qeverinë kombëtare të Tiranës. Në gjysmën e dytë të vitit 1920 ajo përballoi një rrezik të ri: ndërhyrjen ushtarake të shtetit serbo-kroat-sllloven (Lufta e Koplikut).

Shkodra ka qenë një nga vatrën kryesore të levizjes demokratike-revolucionare në vitet 1921-1924. Në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese (27.12.1923), me shumicë dërrmuese votash, fitoi opozita. Nën të 31 majit 1924 forcat revolucionare më në kontroll qytetin dhe nga këtu u nisën për në Tiranë. Në vitet 1924-1939 pati një zhvillim industrial të ngadalte, u ngritën fabrika të vogla, punishte të industrisë ushqimore, të tekstilit e cimentos. Më 1923 Shkodra kishte 20.000 banorë. ndërsa më 1939 kishte 29.000. Shkodra ishte selia e arkipeshkvise, nga vareshin 30 dioqeza dhe këtu më 1930 u hap një shkollë popullore laike, më 1922 Gjimnazi i Shtetit, Konvikti «Malet tona», shoqëria sportive e kulturore «Vllaznia». Pushtuesit fashistë u pritën me armë në dorë, dhe qendresa kundër tyre vazhdoi me greva e demonstrata.

Politika. Në Shkodër janë aktive të gjitha forcat politike PD, PS, PBDNJ, LSI etj. Kryetare e Bashkisë është Zj. Voltana Ademi. Deputetët e Shkodrës në Parlamentin Shqiptar së fundmi janë Romeo Gurakuqi, Izmira

Ulqinaku, Lorenc Luka, Helidon Bushati, Nard Ndoka, Ditmir Bushati, Paulin Stërkaj, Senida Mesi, Luan Harusha, Paulin Luli, Teuta Qyteza-Shala, Alfons Babani, Vilson Masmalaj, Majlinda Laçe, Myzafer Bushi, Pjetër Nika, Ledia Nika

Prefekte e Qarkut Shkodër është z. Çesk Millja.

Kryetari i Qarkut të Shkodrës është Z.j Greta Bardeli

Ekonomia Ekonomia ne kete treve, si proces zhvillimi, daton qe prej me se 2400 vjetesh. Shkodranet qe ne vitin 212 para Krishtit perdornin monedhen e tyre "SKODRINON"si mjet kembimi, gje qe flet per nivelin e larte te organizimit te ekonomise ne ate kohe. Dhoma e Tregtise ne Shkoder, ne dobi te zhvillimit te biznesit, daton qe ne vitin 1736.

Pozicioni gjeografik i Shkodrës është i volitshëm për lidhjen tokësore, ujore dhe ajrore. Qyteti i Shkodrës parashikohet të jetë porta hyrëse e koridorit veri–jug për trafikun ndërkombëtar, duke u përfshirë në rrjetet rrugore europiane. Shkodra lidhet me kryeqytetin e vendit Tiranën me anë të autostradës Tiranë-Shkodër, pjesë e korridorit Veri-Jug, me gjatësi 98 km. Distanca me Kosovën nëpërmjet rrugës së Kukësit është 170km. Shkodra lidhet me Malin e Zi nëpërmjet rrugës veriore Shkodër-Hani i Hotit (35km), nëpërmjet rrugës së Muriqanit (14 km) dhe rrugës Shirokë – Zogaj (16 km).

Pozita gjeografike dhe afërsia me pikat kufitare ndihmon në krijimi e një shtrirje urbane policentrike përtej kufirit me Malin e Zi, duke lidhur përmes transportit ekonomitë urbane të Shkodrës, Lezhës, Shëngjinit, Podgoricës, Barit dhe Ulqinit. Gjithashtu, krijimi i korridorit rajonal nga Kosova drejt portit të Barit apodrejt pikave kufitare veriore të Shqipërisë është një tjetër element me rëndësi në plotësimin e rrjetit të transportit, duke influencuar në zhvillimin e Shqipërisë së Veriut si një rajon i qëndrueshëm dhe i fuqishëm

Shkodra perveç te qenit qendër Administrative e rajonit, këtu kane prezencën e tyre kompanitë me te njohura prodhuese dhe tregtare te vendit përben edhe qendrën me te madhe bankare ne very perëndim te Shqipërisë ku kane selinë e tyre : Banka e Shqipërisë, Banka Kombetare Tregtare, Raiffaisen Bank, Intesa SanPaolo Bank, Alpha Bank, Tirana Bank, NBB Bank, Emporiki Bank, UNION BANK, Banka Popullore.

Aktivitet kryesore ekonomike ne rajonin e Shkodrës jane Tregtia, Turizmi, Industria e ambalazhimit te ujit dhe pijeve freskuese etj. Fabrikat e perpunimit te qumeshtit dhe prodhimit te djathrave dhe nenprodukteve te qumeshtit . Industria e tregtimit dhe perpunimit te Drurit. Industria e prodhimit te Inerteve dhe Ndertimit. Repartet e shumta te prodhimit te veshjeve dhe kepuceve per tregjet e huaja. Industria e nxjertes dhe perpunimit te gurit per ndertim dhe atij dekorativ.

Baza e ekonomisë është bujqësia, por në rajon po rritet dhe industria e përpunimit të ushqimit, duke shfrytëzuar mundësinë që jep prodhimi i frutave, perimeve dhe nënprodukteve blegtorale. Qyteti ka universitet dhe është qendër administrative rajonale. Turizmi po tregon se është një nga shpresat më të mëdha për zhvillimin ekonomik të qytetit, duke u bazuar në trashëgiminë unikale kulturore, historike dhe arkitekturore

Kultura

Shqiptarët me të drejtë e quajnë Shkodrën djepin e kulturës së tyre. Në Shkodër u rritën e u formuan shkrimtarët e parë shqiptarë, si Marin Barleti, Marin Biçikemi, Dhimitër Frangu. Libri i parë i historisë së letërsisë shqiptare “Rrethimi i Shkodrës” është botuar nga humanisti shkodran, Marin Barleti, më 1504. Pas errësirës pesëshekullore turke, ndër të parët do të jetë Pashko Vasa që me këngën hymn “O moj Shqypni”, do të sjellë mesazhet e Rilindjes sonë Kombëtare e kushtrimin e lirisë.

Në vitet 20-30 të shekullit XX, letërsia njih figura madhore të tilla si Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Migjeni e Ernest Koliqi, të cilët me veprat e tyre arritën nivele bashkëkohore në letërsinë ballkanike e atë evropiane. Prandaj nuk janë të rastit as fenomenet letrare të mëvonshme të një kalibri të tillë si Arshi Pipa e Martin Camaj, që formimin e frymëzimit e parë e patën në këtë qytet, edhe pse krijimtarinë letrare e zhvilluan larg vatrës, në diasporë, në Itali, Amerikë e Gjermani.

Letërsia e zhvilluar në Shkodër, si pjesë e letërsisë bashkëkohëse shqiptare, po pasqyron me dinjitet artistik jetën në lëvizjet e saj.

Shkodra njihet edhe si qendra kryesore e muzikës shqiptare. Krahas orkestrinave popullore u zhvilluan edhe formacionet e mëdha, orkestra sinfonike e filarmonia e qytetit, që sollën në skenat tona me profesionalizëm muzikën e lehtë dhe atë klasike, nga repertori i kompozitorëve vendës dhe nga fondi i muzikës botërore. Në fillim të shekullit XX Shkodra kishte 26 piano. Madje koncerti i parë sinfonik, ka qenë “Sinfonia e pambaruar” e Shubertit. Pikërisht në Shkodër, më 1958, u vu në skenë opera e parë shqiptare “Mrika” e kompozitorit Prenkë Jakova.

Edhe piktura ka një traditë të pasur. Më i shquari nga plejada e piktorëve të hershëm është Kolë Idromeno që, me penelin e tij, sjell momente nga jeta e popullit, portrete të njerëzve të thjeshtë e peizazhe. Ndoc Martini prezantohet si

piktor me një frymë të modeluar plastike. Edhe tek piktorët e tjerë të kësaj periudhe shfaqet me interes jeta aktuale, etnografike e folklorike.

Piktorët e skulptorët e pasçlirimit i referohen kryesisht tematikës aktuale. Portretet e tabllotë e Vladimir Janit, Jakup Kerajt, Ismail Lulanit, Danish Jukniut, Edi Hilës, karikaturat e Shtjefën Palushit etj. kanë krijuar individualitete të spikatura në fushën e pikturës së re shqiptare, duke fituar çmime kombëtare e vlerësime ndërkombëtare.

Sporti



Shkodra është qyteti më me tradita në fushën e sportit. Këtu, që më 1918, u zhvillua ndeshja e parë e futbollit (si veprimtari zyrtare) midis “Juventusit” vendës me një skuadër austrohungareze. Në po këtë vit u formua klubi “Vllaznia”. Më 1920 për herë të parë, në vendin tonë, zhvillohen në Shkodër garat çiklistike dhe ato të atletikës. Si inisiator i lëvizjes sportive shquhet Palokë Nika. Janë me dhjetra sportistë shkodranë që duke përfaqësuar me dinjitet e shpirt të lartë gare ngjyrat e sportklubit të tyre janë shquar jo vetëm në kamionate brënda vendit, por edhe në arenën ndërkombëtare. Midis tyre spikat emri i Loro Boriçit, që arriti të luajë edhe në ligën e parë të kampionatit italian të futbollit, kapiteni i madh i Ballkaniadës së fituar nga Shqipëria më 1946-të, ish-tranieri i ekipit kombëtar në futbollin e viteve 70-të. Sot, stadiumi i qytetit me kapacitet afro 30.000 vende, mban emrin “Loro Boriçi”. Klubi “Vllaznia”, si klub shumësportesh, ka fituar disa kampionate si në futboll, basketboll, atletikë për femra, çiklizëm, not, boks, mundje e lirë, mundje klasike, etj.

Teatri “Migjeni”



Ka tradita. Shfaqja e parë është dhënë në vitin 1879. Që në vitet '20 të shekullit të kaluar u krijuan shoqëritë teatrale pranë Gjymnazit të Shtetit, ndërsa në vitet '80, Shkodra u bë qendra e skenës amatore. Teatri profesionist u krijua më 1949 mbi bazën e teatrit amator. Trupa teatrore ka vënë në skenë shumë vepra të repertorit kombëtar dhe të huaj, autorë klasikë e bashkëkohorë. Ajo është pëlqyer jo vetëm në Shkodër e Shqipëri, por edhe në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, ku ka bërë turne të suksesshme për shqiptarët e atjeshëm. Shpesh, në festivalet kombëtare teatrore, është nderuar me çmime nderi. Veç trupës së teatrit funksionon edhe ajo e estradës, e cila me humorin e hollë, është bërë e dashur për vendësit. Ajo qëndron pranë humorit tradicional të tavolinave shkodrane, të bejtave, karnavaleve që i kanë dhënë emrin “Qyteti i humorit”.

Aktorë e regjisorë të shquar kanë shkruar talentin e tyre në skenën e teatrit “Migjeni” dhe janë përjetësuar, si Zef Jubani që i dha jetë si askush tjetër në Shqipëri Harpagonit të Molierit, Tinka Kurti, Tano Banushi, Adem Kastrati, Paulin Sekuj, Serafin Fanko, Zyliha Miloti, Zef Deda, etj., këngëtarë të trupës së estradës si Bik Ndoja, Ibrahim Tukiqi, Shyqyri Alushi, Bujar Qamili etj.

Qendra turistike

Mjedisi gjeografik bregdetar, liqenor e malësor, pasuria kulturore, historike, zakonet, traditat e këtij qytetërimi të lashtë, janë ofertë me plot interesa njohëse në fushën e turizmit.

Velipoja



Në JP të qytetit të Shkodrës, 30 km larg, shtrihet plazhi i bukur i Velipojës, me gjatësi 14 km e me gjërësi rreth 300 m, që krijon mundësi të shumta për shfrytëzimin turistik. Ky bregdet është një perlë e natyrës shqiptare, ku gërshetohen aq harmonishëm deti, lumi, plazhi, pylli, laguna e mali, me një rërë të pasur e të pashfrytëzuar, ujë të kulluar, me një rezervat gjuetie. Velipoja është plazh i ri me vlera kurative dhe me kushte klimatike të favorshme, ku vërehen rreth 100 ditë me temperaturë mbi 25° C. Nëse ju preferoni të pushoni në plazhin e Velipojës, ai të afrojnë mundësi të shumta argëtimi, aty mund të laheni, të bëni shetitje me varkë, të gjuani lepuj e derra të egër, fazana e rosa të egra etj. Për amatorët e peshkimit, deti e lumi i Vilunit pranë plazhit, të afrojnë mundësi peshkimi për qefull e levrek. Në shërbim të turizmit vitet e fundit janë ngritur disa hotele, kabina e mjaft shtëpi luksoze me komoditetet e nevojshme. Rrjeti tregtar është në nivelet e kërkuara. Restorantet të afrojnë meny të kuzhinës evropiane, tradicionale shkodrane e sipas kërkesave. Është organizuar edhe shërbimi komunal, shëndetësor e ai i Postë-Telekomunikacionit. Ky plazh shfrytëzohet edhe si plazh ditor nga banorët e qytetit e të zonave pranë saj.

Rezervati i Velipojës

Ky rezervat ka sipërfaqe 694.5 km². Aty gjenden katër kënetë të mëdha. Ky rezervat ka 182 ha pishë e plep kënete. Rosat e shumëllojta, e sidomos kryekuqet, janë objekt gjuetie. Në pyll takon kafshë të ndryshme si turtuj, gugashë, lepuj, çakej, dhelpra etj. Kënetë, bimësia e shpendët përbëjnë një nga vlerat e rralla në Shqipëri. Aty ruhen të qetë, në gjendje spontane, natyrore.

Shiroka



Fshati turistik Shirokë shtrihet buzë Liqenit të Shkodrës, poshtë malit të Taraboshit, vetëm 7 km larg qytetit. Ky fshat i vjetër përmendet në burimet e shkruara qysh në shekullin XV. Ka kushte të shkëlqyera klimatike dhe është qendër pushimi. Ajri i freskët, që vjen nga thellësitë e Alpeve, filtrohet në ujërat e liqenit dhe vjen i shëndetshëm këtu, rrëzë malit të Taraboshit. Nëse do të dëshironi të qëndroni disa ditë, në dispozicion do të keni një hotel me komoditetet e nevojshme, disa shtëpi të vëna në dispozicion nga vendësit dhe restorante e pika tregtie. Shiroka të afrojnë variacione, mund të bëni plazh, të merreni me peshkim, të bëni shetitje me barkë e të ngjiteni në mal. Shërbimi komunal, shëndetësor e tregtar është i pranishëm edhe këtu.

Razma



Në rrëzë të malit të Veleçikut, rreth 41 km larg qytetit të Shkodrës, ndodhet një nga vendet më të bukura dhe me klimë të shëndetshme të Alpeve, Razma. Këtu, në mes të pishave, lëndinave, kullotave alpine e peizazheve malore, është ndërtuar një kompleks banesash të tipit alpin. Në këto mjedise, vizitorët gjejnë vend të përshtatshëm për ekskursione alpinistike, për ndeshje sportive, gjuetie etj. Në Razëm prania e vizitorëve është gjithëvjetoje, pasi, përveç verës, ajo është tepër e lakmueshme edhe në dimër kur çdo gjë e mbulon dëborë. Rruga automobilistike, rrjeti i nevojshëm tregtar e restorantet janë të një niveli të mirë.

Thethi



Në VL të qytetit të Shkodrës, rreth 80 km larg, në zemër të Alpeve, ndodhet fshati piktoresk i Thethit. Rruga për atje gjarpëron mes pyjesh e peizazhesh mahnitëse. Gjithandej të shoh syri veç kreshta dhe maja që ngrihen mbi luginat e ngushta, plot me pragje e ujëvara. Pasuria shpirtërore e veçantë, për çka flasin dhe gojëdhanat, legjendat e mitet, janë disa nga pasuritë etnokulturore të veçanta, që ruhen e përcillen brez pas brezi, në këto lugina e shpate malesh. Në qiellin e pastër të Thethit shihen të fluturojnë shqiponjat e malit, ku kanë edhe foletë, në lumin e Shalës lëvizin troftat (peshk aq i veçantë me shije të rrallë), kurse shpatet e maleve janë të veshura me pyje shekullore, ku strehohen dhjetëra kafshë të egra, si: arinjtë, kaprojtë, zardafët, ujçit, dhelprat, dhitë e egra dhe shpend nga më të bukurit.

Thethi ka pamjen e një pellgu 800 m mbi nivelin e detit. Është vendosur midis një kurore majash të thepisura si, Radohima, Maja e Arapit, Maja e Alisë, të cilat spikasin për bukuritë e rralla në gjithë Alpet. Përmes fshatit rrjedh lumi i Shalës, i rrëmbyeshëm, me ujë të bollshëm, i pastër si kristali e i ftohtë si akulli. Nga malet me furi e zhurmë zbresin katarakte e ujëvara. Thethi është vendi i kontrasteve të relievit, ujëvarave, bimësisë së dendur, livadheve e sidomos ngjyrave. Është me vlerë të bësh shetitje në këmbë, ku do të afrohen pamje të pazakonta. Aty mund të shikosh se si në mes të pyllit ndodhesh para livadheve ku rrezet e diellit kanë bërë të lulëzojnë lule, që nuk i gjen në asnjë vend tjetër. Thethi karakterizohet nga pyje, kullota e livadhe alpine e subalpine. Parku Pyjor Kombëtar ka sipërfaqe prej 2300 ha. Natyra i ka falur privilegje këtij fshati alpin. Nëse je amator i alpinizmit, i gjuetisë së kafshëve të egra apo i peshkimit, këtu do të gjesh një fushë të gjërë veprimi e argëtimi.

Veç të tjerash, të huajt këtu befasohen nga kostumet tradicionale, mijëravjeçare të vendësve. Ato janë të pranishme sidomos në ditë festash. Po kaq interesante janë zakonet e rruga e jetës së kësaj krahine. Thethi është një pikë turistike e virgjër. Frekuentimi i tij nuk ka probleme mjedisore, ka një qetësi absolute. Aty banon një popullsi e vogël, e shquar për mikpritjen tradicionale. Në shërbim të vizitorëve janë hotelet dhe shtëpitë që venë në dispozicion vendësit. Rrjeti tregtar, telekomunikacioni e qendra shëndetësore janë të pranishme në çdo kohë.

Liqeni i Komanit



Nëse dëshironi të bëni një shetitje të paharrueshme përmes luginave, kanioneve e peizazheve të pazakonta, lundroni në Liqenin e Komanit, i cili ndodhet 30 km larg qytetit. Liqeni është formuar nga ujëmbledhësi i lumit Drin, ku është ngritur Hidrocentrali i Komanit me 600 mijë kë/orë. Liqeni ka sipërfaqe 12 km², gjatësi 34.5 km, gjërësi 50-60 m. Rreth liqenit lartësohen male të pyllëzuara me lartësi 1000-1200 m mbi nivelin e detit.

Ky rajon, veç vlerës turistike, ruan edhe vlera historike. Aty pranë ndodhet fshati Koman, ku është zbuluar një varrezë e shekullit 6-8 e.j., e cila lidhet me kulturën e shoqërisë së hershme shqiptare. Për t'i ardhur në ndihmë turistëve e vendasve, janë vënë në funksionim mjete lundrimi për pasagjerë, makina e mallra. Liqeni i Vaut të Dejës



Ai ndodhet vetëm 23 km larg Shkodrës. Ka një sipërfaqe prej 24.7 km, me thellësi maksimale 52 m, formuar nga ujëmbledhësi i lumit Drin më 1971, ku është ngritur hidrocentrali i Vaut të Dejës me 250 kë/orë. Liqeni është magjepsës për nga bukuria. Kur kalon nëpër gryka të ngushta malesh, brigje pyjesh ose dukurish interesante karsti, ndjehesh i gëzuar. Liqeni shërben edhe për transport, peshkim e turizëm.

Kelmendi



Është një sipërfaqe natyrore mjaft e madhe, e thyer, me diversitet të lartë gjeomorfologjik e biologjik. Pyjet e ahut dhe të haloreve, janë ndër më të bukurit e vendit tonë. Kelmendin e përshkon Cemi, ndër lumenjtë më të bukur të vendit tonë. Troftat e tij janë me nam. Pyjet popullohen nga dhitë e egra, kapronjtë, arinjte e gjithnjë lart, në qiellin e kulluar, futurojnë shqipet, që personifikojnë më së miri këtë zonë interesante. Veçanërisht Lëpusha dhe Vermoshi ruajnë vlera e bukuri të papërsëritshme; ato janë zona piktoreske me vlera të mëdha klimatiko-turistike. Lugina e Vermoshit është me origjinë akullnajore, ku është vendosur edhe fshati alpin me të njëjtin emër. Ky rajon, me pyje madhështore, me livadhe të gjelbra e plot lule, është një alternativë tjetër, që përbën një faktor tërheqës turistik.

Gastronomia



Një imazh të mirë për Shkodrën jep dhe gastronomia. Një numër i madh restorantesh, picerish, bufesh e hotelesh janë ngritur në qytetin tonë, ku kultura e shërbimit tradicionalisht është prezente. Arti i shijes është i ndjeshëm, por sot ekonomia private është e aftë të mbështesë e të sigurojë garanci për ushqime të freskëta natyrore e për të rritur nivelin e turizmit.

Thuhet se gastronomia e qytetit të Shkodrës e ka prejardhjen nga ajo turke, por, tradita mijëvjeçare ka adaptuar ushqimin me të cilin prezantohet në tryezë, pra ka preferencat e traditën e vet të gatimit e të shijes. Vera “Kallmet” (fituese e disa çmimeve ndërkombëtare), rakia e rrushit (dhuratë e rrushit me cilësi të kultivuar në zonat për rreth) si dhe menyuja tradicionale, përgjithësisht është e pëlqyeshme për të huajt, që provojnë shijen tonë.

Bashkia Shkodër ka kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe artit , nëpërmjet ruajtjes dhe zhvillimit të trashigimisë kulturore dhe asaj shpirtërore, duke zgjeruar llojshmërinë e festave dhe aktiviteteve tashmë të përvitshme. Nga viti në vit ne kemi rritur në mënyre të konsiderueshme numrin e aktiviteteve si rezultat i bashkëpunimit me institucionet e artit dhe kulturës, shoqëritë kulturore etj. Bashkia Shkodër, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe turizmit si dhe zhvillimit të integruar dhe të balancuar të të gjithë territorit të saj, organizon çdo vit edhe një sërë aktiviteteve tashmë tradicionale, duke u fokusuar në promovimin e produkteve të sektorit bujqësor agropërpunues sipas njësive administrative të Bashkisë Shkodër. Në këto aktivitete prezantohen të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe gatimin tradicional.

KARNAVALET

Organizohen nga Bashkia Shkodër çdo vit gjatë muajit shkurt. Historia e karnavaleve në qytetin e Shkodrës ka nisur që në vitin 1860 dhe ka vazhduar deri në vitin 1943. Por për shkaqe politike, mbas vitit 1943, kjo festë filloi dhe u zbeh. Kolë Shiroka njihet si një ndër mjeshtrit e parë për organizimin e karnavaleve të Shkodrës.

DITA E LULEVE

Organizohet më 6 Maj nga Bashkia Shkodër çdo vit me një sërë aktivitetesh artistiko-kulturore si: panairë, koncerte artistike dhe aktivitete të ndryshme nga shkollat e qytetit.

DITA E ARTIZANATIT DHE E ZEJEVE

Aktiviteti zhvillohet në muajin qershor dhe zgjat 2-3 ditë në qendër të qytetit. Ky aktivitet konsiston në promovimin e punimeve artizanale të prodhuar nga mjeshtrit e talentuar Shkodranë

PANIRI I "PROMOVIMIT TË VLERAVE DHE RESURSEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, NATYRORE DHE PRODUKTEVE TERRITORIT"

Ky aktivitet realizohet në mbështetje të zhvillimit të integruar dhe të balancuar të të gjithë territorit të saj për promovimin e produkteve të sektorit bujqësor agropërpunues dhe atij artizanal sipas Njësive Administrative të Bashkisë Shkoder

DITA NDËRKOMBËTARE E MUZEUMEVE

Organizohet më 18 maj nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me institucionet e trashëgimisë kulturore, si Muzeu Historik "Oso Kuka", Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës, Muzeu i Kështjellës.

DITA BOTËRORE E MUZIKËS

Data 21 qershor është shpallur si dita botërore e muzikës. Prej vitesh në Shkodër në këtë datë, zhvillohet një koncert vokal instrumental i muzikës serioze.

FESTIVALI MBARËKOMBËTAR I KËNGËS PËR FËMIJË

Që nga krijimi i tij, në vitin 1963, zhvillohet në qytetin e Shkodrës, çdo vit në muajin qershor, Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë/HAPJA E SEZONIT TURISTIK NË VELIPOJË Aktivitetet me rastin e hapjes së sezonit turistik, në plazhin Velipojë, i cili organizohet nga Bashkia Shkodër, në muajin Maj.

DALJA NË BJESHKË Çelja e sezonit të turizmit malor, të Alpeve të Shqipërisë, në fshatin Theth, në muajin Qershor.

DITA E LIQENIT Organizohet në muajin qershor. Promovimi i turizmit në liqenin e Shkodrës. Gjatë kësaj dite organizohen një sërë aktivitetesh sportive ujore, si maratonë noti, aktivitete sportive me veliera, kanoe, ëndersf etj. TRIATHLON Aktiviteti i përvitshëm që zhvillohet në muajin shtator. Ky aktivitet organizohet nga shoqata Ëater Sports on the Lake Albania me mbështetjen e Bashkisë Shkodër.

DITA BOTËRORE E TURIZMIT Organizohet nga Bashkia çdo vit në muajin shtator.

DITA E BIÇIKLETAVE Shkodra, qyteti i biçikletave, organizon çdo vit, në muajin tetor, aktivitetin "Dita e biçikletave".

AHENGU SHKODRAN Organizohet më 29 shtator nga Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", në ditën e trashëgimisë kulturore. Aktiviteti synon të promovojë traditën e ahengut, i cili është shpallur si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore shqiptare.

NDËRMENDJE Koncerti i fundvitit, i kthyer tashmë në traditë, i cili organizohet çdo fund dhjetori, me pjesëmarrjen e orkestrës simfonike të qytetit.

*Klima, Diellezimi. Klima e Shkodrës përcaktohet nga llojshmëria e relievit fushor, kodrinor, paramalor dhe malor, nga afërsia me Detin Adriatik si dhe nga liqeni i Shkodrës. Karakterizohet nga një klimë mesdhetare me dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Në dimër fryn era e murlanit (erë lokale), e ftohtë, e fortë dhe e thatë, ndërsa në fund të vjeshtës fryn era e shirokut, që shoqërohet me reshje dhe fryrjen e lumenjve. Sasia e reshjeve në këtë qytet është e madhe. Mesatarisht bie 2500 mm shi në vit, pra një nga zonat më të lagështa të Shqipërisë. Muaji më i ftohtë i vitit është muaji janar, ndërsa muaji më i nxehtë i vitit është muaji korrik. Reshjet e dëborës bien rrallë, ndërsa ngricat shënohen zakonisht në fundin e vitit.

*Temperatura

Zona në studim ka një klimë mesdhetare fushore qendrore. Klima e kësaj zone karakterizohet nga dimra të bute e të lagur dhe vera të thate e të nxehta, Reshjet bien në forme shiu. Shtresa e bores është e paperfillshme dhe me kohezgjatje mjaft të shkurtra. Temperatura mesatare shumevjegare është 15.1°C. Reshjet mesatare shumevjegare janë 1210 mm. Lartësia e bores në raste shume të rralla shkon nga 5 deri në 10 cm.

Temperatura e ajrit është një nga elementet kryesor klimatik që shërben për të karakterizuar klimën e një vendi apo një rajoni. Me regjimin mesatar, me ecurinë e saj vjetore e ditore si dhe me vlerat ekstreme, ndikon në strukturat ndertimore. Me temperaturën janë të lidhura rritja dhe zhvillimi i bimëve, proceset e tjera fiziologjike (frymëmarrja, avullimi, fotosinteza etj). Në përgjithësi, temperatura optimale e rajonit të Shkodrës është më e përshtatshme për

zhvillimin e jetës së bimës. Sikurse u citua më lart, përveç temperaturës optimale bimët mund të rezistojnë edhe në temperature të ulëta (minimale) ose të larta (maksimale). Jashtë këtyre kufijve, bimët dëmtohen menjëherë. Temperatura mesatare në qytetin e Shkodrës është 14.80 C. Deti Adriatik dhe liqeni i Shkodrës ushtron një ndikim zbutës, si ndaj klimës së ftohtë të dimrit dhe të nxehtë të verës

Nje nga parametrat me te rendesishem te temperatures se ajrit eshte temperatura mesatare e tij.

Tabela paraqet - Temperatura mesatare mujore dhe vjetore e ajrit

Temp.mes. vjetore	15 .3 0 C	Orë me diell në vit	2600
Temp.mes. Janar	4 .7 0 C	Vlefte mes. Ngrohtësisë	50 . 24 Kka l / c m 2
Temp.mes. Korrik	26 .0 0 C	Lagështia mes. Vjetore	66%
Temp.max. shekullit	43 .0 0 C	Lagështia min. Gusht	53%
Temp.min. shekullit	- 22 .0 0 C	Lagështia max. Nentor	77%
Temp.mes. ujit liqenit	16 .4 0 C	Ditë dëbore mes. Vjetore	2-3
Sasia mes. vjetore reshjeve	1 7 0 0 mm	Shpejtësia e erës	deri 25-45m/s
Sasia max. vjetore reshjeve	2 5 0 0 mm	Drejtimi i erës, kryesisht	Verilindore,jugore

*Reshjet atmosferike

Reshje quajm të gjitha format e ujit, të cilat nga atmosfera bien në sipërfaqen e tokës. Reshjet formohen me ngopjen e ajrit me lagështi dhe ftohjen e tij gjatë ngritjes, me ç'rast vjen deri te kondenzimi apo sublimimi. Reshjet maten kryesisht me shimatës dhe shprehen me mm (milimetra), që nënkupton se 1 mm është e barabartë me 1 litër ujë në 1 metër katrorë (m²). Ndërsa bora matet me vizorin e borës dhe shprehet me centimetër (cm). *Qyteti i Preshevës mesatarisht gjatë vitit pranon 631.2 mm, Peja 846 mm, Shkodra 1456 mm. Më së shumti reshje në botë pranon lokaliteti Çerapunxi në krahinën Asam, të Indisë me 12600 mm.* Në hartat klimatike me ndihmën e izohijeteve paraqiten vendet me sasi të njejtë të reshjeve.

Përhapja e reshjeve varet nga: *temperatura e ajrit, shtypja atmosferike, afërsia e detit, relievi, rrymat detare, etj.* Më së shumti reshje bien në *brezin e ngrohtë*, deri 20° gjerësi gjeografike veriore dhe jugore, e sidomos përgjatë ekuatorit ku mesatarisht bien nga 2000 deri 3000 mm reshje. Në mes 20° dhe 40° gjerësi gjeografike veriore dhe jugore bien më së paku reshje, më pak se 200 mm, përshkak të shtypjes së lart atmosferike dhe zbritjes së ajrit të thatë. Ky është brezi i shkretirave. Përjashtim bëjnë Azia jugore dhe juglindore, në të cilat fryejn monsunet, të cilat sjellin sasi të mëdha të reshjeve. Në *brezin e mesëm* reshjet gjatë vitit janë nga 500-1000 mm. Më të larta janë pran bregdetit ndërsa duke shkuar kah brendësia e kontinentit ato ulen në më pak se 250 mm, si psh. në Azin e mesme dhe në qendër të amerikës veriore ku kemi edhe shkretirat. *Brezat e ftohtë* pranojnë nga 200-300 mm reshje edhe atë kryesisht në form të borës. Mirpo, duke shkuar kah brendësia e Arktikut dhe Antarktikut reshjet janë edhe më të ulëta. Përveç sasis së reshjeve shumë me rëndësi është edhe shpërndarja e tyre gjatë muajve të vitit. Kjo njihet si regjimi i pluviometrik (reshjeve), i cili ka rëndësi për bujqësin, sidomos për periudhën vegjetative të bimës.

*Lageshtia e ajrit

Lagështira e ajrit është një element tjetër i rëndësishëm, që ndikon në krijimin e mikroklimës së qytetit të Shkodrës. Përmbajtja e lagështirës në ajër krijon kushte potenciale, për rënien e reshjeve, duke ndikuar botën bimore. Qyteti i Shkodrës njihet për potencialet e mikroklimës së lagësht si rrjedhojë e avullimit të sipërfaqeve të ekosistemeve liqenore, lumore e detare të këtij rajoni. Vlerat më të larta të lagështirës relative të ajrit në qytetin e Shkodrës janë shënuar në muajt nëntor dhe dhjetor, ndërsa vlerat më të ulëta të lagështirës relative vërehen në muajt korrik-gusht. Si nje tregues i rendesishem i lageshtires se ajrit sherben lageshtia relative e ajrit sherben lageshtia relative e ajrit e cila ka nje ndikim te drejtperdrejte ne aktivitetin njerezor. Ne ecurine vjetore te ketij treguesi verehen ndryshime qe jane kushtezuara nga qarkullimi stinor dhe relievi. Te dhenat e tabelës Nr. 14 tregojne se vlerat me te larta te lageshtires relative te ajrit vrojtohen ne gjysmen e ftohte te vitit, gje qe shpjegohet me veprimtarine ciklonare qe vrojtohet ne zonen e marre ne studim gjate kesaj periudhe te vitit.

Vlerat me te larta i takojne muajve Nentor, Dhjetor dhe Janar. Nderkaq vlerat me te uleta e lageshtires relative vrojtohen ne muajin Korrik dhe Gusht, pikerisht kur mbi rajonet e Mesdheut verehet nje qendrushmeria anti-ciklonare e theksuar. Ecuria ditore e lageshtires relative eshte e kundert me ate te temperatures se ajrit. Ne oret e para te mengjesit realizohen vlerat me te larta kurse ne oret e mesdites (para ose pas mesdites) vlerat me te uleta.

Ne zonen ne studim mbizoteron forma qarkullimit perendimor i cili duke u gvendosur nga perendimi ne lindje, sjell me vete masa ajrore te pasura me lageshtire dhe relativisht te ngrohta. Gjithashtu rritja e sasise se reshjeve nga fundi i vjeshtes dhe fillimi i pranveres ben qe lageshtia relative gjate vitit te qendroje ne vlera pothuajse te peraferta.

Tabela paraqet, ecurine e lageshtires relative gjate vitit

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes. Vjetore	Amplituda
Shkoder	73	71	71	72	71	66	61	64	70	72	76	76	70	15

Per kete arsye, zona ne studim ka vlere relativisht te larte te lageshtires eshte relative dhe me ndryshime jo shume te ndjeshme nga muaji ne muaj me tjetrin. Amplituda vjetore midis vleres me te larte 76% dhe asaj me te ulet 61% eshte 15%. Lageshtia mesatare vjetore eshte 70%.

RELIEVI : Bashkia Shkodër është e vendosur në një reliev fushor e kodrinor në një lartësi 25.3 m mbi nivelin e detit. Pjesën më të madhe të qytetit e dominon relievi fushor, kryesisht në pjesën veriore. Zona fushore e qytetit kufizohet: nga lindja me lumin Kir e Drin; nga perëndimi me liqenin e Shkodrës; nga veriu me fushën e Shtojit dhe më tej përroi i Vrakës, ndërsa nga jugu me vargun e kodrës së Tepes e malin e Taraboshit. Relievi i ngritur përfaqësohet nga e ashtuquajtura kurorë e qytetit të Shkodrës, që shtrihet në pjesën periferike të qytetit të Shkodrës dhe përbëhet nga: kodrat e Rrencit, Tepes dhe mali i Taraboshit. **KLIMA**: Shkodra karakterizohet nga klima tipike mesdhetare, me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër relativisht të butë dhe të lagësht me shira. Kushtet klimatike të qytetit të Shkodrës janë formuar nën veprimin e një sërë faktorësh. Në këtë aspekt mund të rendisim: ♣ Relievi i ulët fushor, i cili ndikon temperaturat, reshjet, erërat etj; ♣ Relievi i lartë malor i Alpeve në veri e lindje, prej nga zbresin erëra të ftohta; ♣ Depërtimi i erërave të ftohta që zbresin nga malet e Malit të Zi; ♣ Ndikimi detar nga perëndimi e jugperëndimi, por edhe ndikimi i relievit kodrinor të vargut Tepe-Kala-Tarabosh; ♣ Pozicioni verior i qytetit ndikon intensitetin e rrezatimit diellor; ♣ Rol të rëndësishëm luajnë erërat lokale si murlani dhe shiroku, që alternohen zakonisht gjatë dimrit, por edhe gjatë gjysmës së dytë të vjeshtës dhe gjysmës së parë të pranverës. **RREZATIMI DIELLOR**: Rrezatimi diellor ofron dritën e cila ka shumë rëndësi për procesin e lulëzimit të bimëve. Mbështetur në të dhënat zyrtare të INEUM, në territorin e Bashkisë Shkodër ka rreth 2505,8 orë me diell brenda një viti, ndërsa vlera më e lartë e zgjatjes mujore të diellzimit është regjistruar në muajin korrik me 354.4 orë. Në tabelën 1 jepet diellzimi mujor në qytetin e Shkodrës.

Mbështetur në vrojtimin e (INEUM 2015) është konstatuar se muajt qershor, korrik dhe gusht (periudha e verës) i kanë thujse të gjitha ditët me diell. Ky fakt është tregues i qartë i potencialit të lartë që ka territori i bashkisë Shkodër për rritjen dhe kultivimin e prodhimeve bujqësore, bimësisë natyrale dhe asaj dekorative. Kjo është edhe një nga arsyet e traditës shkodrane për kultivimin dhe rritjen e bimësisë së oborreve, egzistencën dhe qëndrueshmërinë e bimëve autoktone si dhe rritjen e kultivimin e produkteve bujqësore në fushat e Nënshkodrës. **AJRI**: Në përgjithësi cilësia e ajrit në qytetin e Shkodrës konsiderohet brenda standardeve të BE. Mbështetur në Raportin Kombëtar për gjendjen e Mjedisit 2015 treguesit e cilësisë së ajrit për qytetin e Shkodrës janë si në tabelën më poshtë:

***Era**

ERËRAT: Regjimi i erërave është i lidhur ngushtë periudhën stinore, pozicionin qytetit të Shkodrës si dhe ndikimin e detit Adriatik. Në Shkodër fryjnë erëra që ndryshojnë shpesh gjatë vitit si nga drejtimi ashtu dhe nga shpejtësia. Në drejtimin e erërave ndikon afërsia me detin, drejtimi i vargmaleve dhe i luginave të lumit Kir dhe Drin. Drejtimin mbizotërues të erërave në qytetin e Shkodrës e vërejmë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1.3. Shpërndarja e drejtimit të erës në përqindje dhe sasia e reshjeve në qytetin e Shkodrës (Burimi: INEUM 2015)

Veri	0,6%
Verilindje	2,3%
Lindje	10,5%
Juglindje	7,1%
Jug	5,8%
Jugperëndim	4,3%
Perëndim	5,2%
Veriperëndim	3,4%

Nga treguesit e tabelës 3 rezultojnë se vlerat më të mëdha të përqindjes i kanë drejtimet lindore me 10.5% e juglindore 7.1%. Erërat karakteristike që përshkojnë qytetin e Shkodrës janë: murlani, shiroku, veri dhe juga. Murlani është erë e fortë dhe përgjithësisht e thatë, që vjen nga veriu dhe verilindja nëpërmjet luginës së Drinit, Kirit dhe Rrjodhit. Gjatë dimrit, zakonisht fryn 2-3 ditë pa ndërprerje. Shiroku është erë e nxehtë, gjatë periudhës së dimrit rrymat e shirokut ndihmojnë në shkrirjen e dëborës, që fryjnë liqenin dhe lumenjtë e Shkodrës. Në qytetin e Shkodrës karakteristikë është qarkullimi lokal i erës “briza”, sidomos në verë. Qyteti i Shkodrës në verë ka 36 ditë me brizë, ndërsa gjatë vitit numërohen rreth 93 ditë me brizë.

*Sizmiciteti

Në zonën e Shkodrës që përkon ndryshe me pjesën veriperëndimore të Shqipërisë, vërehet pikë takimi apo planet e ndarjes së disa nga zonave tektonike të Albanideve dhe pjesë të ultësirës ndërmallore e mbivendosur, siç mund të konsiderohet zona e ulët e Shkodrës. Një mpleksje e tillë e shumë zonave tektonike ndarë me plane thyerjesh me shtrirje gjatësore nga verilindja në jugperëndim dhe veriperëndim-juglindje dhe nga tërthorja Shkodër-Pejë ose ndryshe thyerja e Drinit, tregon shumë, pse rajoni i Shkodrës ka qenë dhe mbetet me aktivitet tektonik, neotektonik dhe sizmik të konsiderueshëm. Në të gjitha zonat sipas periudhave kanë ndodhur ngjarje të ndryshme të intensitetit të rrudhosjes, të uljes ose të ngritjes, apo të fundosjes, lidhur këto dhe me përbërjen gjeologjike me qëndrueshmëri të ndryshme. Qyteti i Shkodrës sipas hartës së rajonizimit sizmik të Shqipërisë gjendet në një nga zonat e vatrave të fuqishme të vendit tonë, ku mund të priten tërmete me magnitudë 6.4-6.9 ballë. Zona e Shkodrës është nga ato zona të vendit tonë që është tronditur disa herë nga tërmete të fuqishme, prej të cilëve shquhen tërmeti i 1 qershorit 1905. Tërmeti me fuqi 9 ballë shkatërroi 52 1500 shtëpi, duke lënë 200 të vrarë dhe 500 të plagosur; dhe në 15 prill 1979, të cilët janë dokumentuar mjaft mirë sipas të dhënave instrumentale ku janë dëmtuar 17 118 shtëpi e objekte social-kulturore Megjithëse ishte fillim shekulli, pasgoditjes së fuqishme të tërmetit të 1 qershorit 1905 janë rregjistruar mbi 500, nga stacionet sizmologjike europiane, qoftë edhe nga kronistët e kohës. Gjithashtu në 1943 regjistrohet një tërmet tetë ballësh. Tërmeti i 15 prillit 1979 u shoqërua nga një numër i madh pasgoditjesh, të cilat vazhduan deri në pranverën e vitit 1980. Duke u bazuar në të dhënat sizmologjike, vihet re se zona e qytetit të Shkodrës, përfshihet në zonën, e një prej vatrave më të fuqishme të vendit tonë. Sipas të dhënave sizmotektonike rezultojnë se potenciali sizmik i pritshëm, për ngjashmëri me tërmetet që kanë ndodhur, është 6.5-7.0. Si rrjedhojë vlera e magnitudës $M=7.0$ është vlerë me probabilitet ndodhjeje tërmeti të fortë në këtë vatrë. Që nga tërmeti i 15 prillit 1979, vatra e zonës së qytetit të Shkodrës vazhdon të paraqitet aktive me çlirim të vazhdueshëm të energjisë. Zona e Alpeve të Shqipërisë është më pak e prekura nga lëkundjet e tërmeteve. Shqipëria është dominuar nga mikrotërmete dhe nga tërmete fare të vegjël. Gjatë vitit 2008 kanë rënë një numër i konsiderueshëm tërmetesh me një intensitet prej 3 ballë dhe të paktë kanë qenë ata me intensitet 4 dhe 5 ballë. Në vitin 2012 tërmetet kanë qenë në numër të vogël vetëm me intensitet 3-3.5 ballë. Duke u bazuar sa më sipër mund të përcaktohet edhe nxitimi maksimal që mund të gjenerojë një tërmet të tillë në shkëmbenjtë rrënjësorë. Për mikrozonimin sizmik të qytetit të Shkodrës, dallojmë këto zona: 1. Zona me intensitet maksimal të pritshëm 7 ballë, e cila zë 9% të territorit, dhe përfshin pjesën kodrinore Tepe-kala Rozafa si dhe rrëzën e malit të Taraboshit; 2. Zona me intensitet maksimal të pritshëm 7.5 ballë, e cila zë 12% të territorit, ku përfshihet pjesa veriperëndimore e qytetit në zonën industriale; 3. Zona me intensitet maksimal të pritshëm 8 ballë, e cila zë 32% të territorit, ku përfshihet pjesa qendrore e qytetit të sotëm dhe rrëzën e kodrave të Tepe-kala Rozafa; 4. Zona me intensitet maksimal të pritshëm 8.5 ballë, e cila zë 40% të territorit, ku përfshihet pjesa perëndimore e qytetit, lagjia Bahçallek dhe Tabakët; 5. Zona me intensitet maksimal të pritshëm 9 ballë, e cila zë 9% të territorit, dhe përfshin pjesë të kufizuara të qytetit të Shkodrës.

*Gjeologjia dhe gjeomorfologjia

Në territorin e Bashkisë Shkodër gjejnë përhapje shkëmbinj dhe dhera me litologji të ndryshme të moshave nga Permiani e deri në Kuarternar. Këto shkëmbinj dhe dhera i përkasin zonave tektoniko – faciale të “Gashit”, n/zona “Vermoshi”, të Alpeve Shqiptare, të “Mirditës”, të “Krasta - Cukalit” dhe të “Krujës. Në territorin e Bashkisë në sipërfaqe shfaqen shkëmbinj rrënjësore dhe dhera të kuaternarit të tipit mbulesor por që kanë trashësi të tilla që nuk mund të neglizhohen gjatë kryerjes së ndërtimeve në fushëpërhapjen e tyre. Shkëmbinjtë dhe dherat ndahen në grupe:

- Shkëmbinj të fortë 48
- Shkëmbinj mesatare
- Shkëmbinj të butë
- Dhera pa kohezion
- Dhera me kohezion
- Dhera me veti speciale

Për vlerësimin e kushteve gjeologo – inxhinierike të trojeve të ndërtimit rolin kryesor e luajnë vetite fiziko mekanike (ose gjeoteknike) të tyre. Gjithashtu rol të madh ka edhe pozicioni i gjeografik dhe gjeomorfologjik i tyre. Për këto arsye për trojet të ndërtimit të Bashkisë Shkodër do të trajtohen 2 çështje: • Kushtet gjeomorfologjike • Vetite fiziko – mekanike (gjeoteknike)

Territori i Bashkisë Shkodër shtrihet në një hapësirë me kontraste të medha përsa i përket kushteve gjeomorfologjike. Ai fillon që nga male të larta në veri dhe në lindje e deri në bregun e detit në jugperëndim. Brenda këtij territori gjenden zona fushore të sheshta ose gati të sheshta, shpate kodrash të buta deri mesatare, shpate malore të pjerrta deri të thiketa, shpate të luginave lumore të formave të ndryshme, deri në kanione si dhe bregdet të tipeve akumulativ. Për lehtësi vlerësimi të gjithë territorin e Bashkisë është në 3 njesi kryesore morfologjike: o Njesia morfologjike fushore o Njesia morfologjike kodrinore o Njesia morfologjike malore Njesia morfologjike fushore zë një pjesë të konsiderueshme të territorit. Në njesia fushore perëndimore – jugperëndimore ka përhapje që nga bregdeti në jugperëndim Velipoja dhe deri në veriperëndim në zonën e Hotit. Dy janë fushat kryesore që përbejnë këtë njesi; fusha e Nenshkodres dhe ajo e Mbishkodres. Fusha e Nenshkodres në vetvete përbehet nga disa fusha të rëndeve me të ulta si ajo e Velipojes, Luarzes, Trushit Dajçit, Bushatit, Mjedes, Stajkes dhe Berdices. Janë fusha të sheshta me kuota nga 0,0 m deri në 5 m, rralle deri 20m (fusha e Mjedes). Kanë një pjerrësi shumë të vogël deri horizontale. Nga ana gjeologjike ndertohen kryesisht nga argjila të perziera me material ranor. Përshkohen nga një sistem i dendur kanalizimesh dhe përdoren edhe për kultivim të kulturave bujqësore. Fusha e Mbishkodres në vetvete përbehet nga disa fusha të rëndeve me të ulta si ajo e Shtojtit, Gruemires, Koplikut (Fig 16), Buzes së Ujit dhe Bajzes. Janë fusha me kuota nga 5 m (kuota e Liqenit të Shkodres) deri në 300 m (në afërsi të Dedajve). Kanë një pjerrësi mesatare deri të pjerrta. Pjerrësia e tyre arrin deri 3 - 4° rralle 5 - 6°. Nga ana gjeologjike ndertohen kryesisht nga rera dhe zhavorë të perziera me material argjilor dhe me pak nga argjila. Njesia morfologjike kodrinore zhvillohet jug, jugperëndim dhe perëndim. Menjehere sapo përfundon njesia fushore shfaqen format e kodrave të cilat kanë kuota nga 50 m deri në 700 m. Në vartësi të strukturave gjeologjike ku ato gjenden shfaqen edhe forma relievi tipike si p.sh, relievet kodrinore të strukturave monoklinale dhe relievet kodrinore të strukturave të rrudhosura. Rajon tipik ku shfaqen format morfologjike të strukturave monoklinale është brezi i kodrave nga Gruemire deri në Bajze. Nga ana gjeologjike ndertohen kryesisht nga gelqeroret e jurasi-kretakut të zonës së Alpeve Shqiptare. Kuotat e tyre levizin nga 50 deri 450m. kanë pjerrësi të shpatëve në perëndim të butë dhe në lindje me të lartë deri në 30°. Strukturat e rrudhosura antiklinale kemi kodrat në afërsi të Velipojes (Vazhdimi veriperëndimor i Kurrizoreve të Kakarriqit dhe Rrencit) ndertohen kryesisht nga gelqeroret e kretakut të sipërm dhe eocenit të zonës Kruja dhe kodrat e Bushatit dhe Berdices Tepes dhe Oblikes të cilat ndertohen nga depozitimet flishore të zonës Krasta - Cukali dhe Kruja. Shpatet e këtyre kodrave kanë pjerrësi nga 5 deri në 350 dhe drejtime rënie të ndryshueshme. Kuotat e tyre janë të ulta nga 50 deri 150m. Shpatet shpesh janë të rrumbullakosur nga modelimi i shkaktuar nga rrjedhjet ujore sipërfaqësore. Njesia kodrinore në Bashkinë e Shkodres është e zhvilluar edhe lindje të qytetit të Shkodres në zonën Bardhaj - Guri i Zi – Mazrek - Vilze. Këtu kodrat paraqiten në mënyrë të shregullt kjo për faktin se kanë përberje të ndryshme gjeologjike nga gelqeroret e Alpeve Shqiptare; gelqeroret e zonës Krasta - Cukalit (Kodrat e Sheldisë); flishi dhe Shëmbinjtë ultrabazike të masivitetit të Bardhanjoreve. Kanë shpate në përgjithësi shpate të butë dhe kuota të vogla nga 50 deri 600 m. Njesia kodrinore e zonës Mnele – Gomsiqe – Korthpule shtrihet në jug të Bashkisë tonë. Shpatet e tyre janë me pjerrësi mesatare deri 25°. Kuotat levizin nga 150 deri 600 m. Nga ana gjeologjike ndertohen nga shkëmbinj ofiolitike të zonës Mirdita masivi ultrabazik I Gomsiqes dhe vazhdimi verilindor i masivitetit gabro - peridotit të Kashnjetit. Njesia morfologjike malore zë një pjesë të rëndësishme të sipërfaqes së Bashkisë tonë. Ajo shtrihet në pjesën veriore verilindore dhe lindore të territorit të bashkisë. Ajo fillon me shpatet malore të Alpeve Shqiptare nga kufiri shtetror me Malin e Zi në perëndim deri në kufi me 51 qarkun e Kukësit. Karakteristike kryesore janë kreshtat e larta, luginat e thella dhe shpatet e thepisura. Këto karakteristika i japin zonës malore të bashkisë të Shkodres një vlerë të lartë në aspektin turistik.

Përsa i përket shfrytëzimit të energjisë gjeotermale territory i Bashkisë Shkodër ofron mundësi të pakta. Bazuar në hartën e mësipërme, zona e Velipojës është ajo që ka potencialin më të madh për përdorimin e energjisë gjeotermale. Gjithësesi, në krahasim me zona të tjera në territorin e Shqipërisë, është relativisht e vogël.

*Erozioni

Pergjithesisht erozoni zhvillohet ne siperfaqen e ngritur, kudo ku eshte krjuar nje disivei, por ne zonen ku do te implementohet ky projekt zhvillim me te madhe ka mbi shembinjte e perarjuar dhe te shkaterruar nga veprimtaria gerryese te rrjedhjeve ujore duke filluar qe nga rreket e deri tek kanalet kulluese aty prane zones.

Kjo dukuri eshte takuar ne pjesen prane skarpates se kanalit. Nje nga efektet me

kryesore te erozionit eshte rreshqija e tokes, nje efekt negativ per vete tokes dhe i rrezikshem per zonat e banuara perreth qe ndodhen te vendosur ne pjesen kodrinore.

Ne zonen ne vleresim nuk ka objekte banimi prane tij si dhe projekti ne vleresim eshte larg vijes se rrezikshmerise.

*Rreshqitja

Rreshqitjet ne kete zone te implementimit te projektit, nuk perben rrezik per te pasi eshte toke fushore dhe dhe e sistemuar, eshte i ndjeshem vetem prane shtratit te kanalit te kullimit ne nje pjese te tij por ne nivele te ulta.

*Kushtet hidrogeologjike dhe hidrologjike

Për studimin e situatës hidrogeologjike të Bashkisë Shkodër është bërë interpretimi i të dhënave hidrogeologjike të marra nga harta hidrogeologjike e Shqipërisë. Nga pikëpamja hidrogeologjike, territori i Shqipërisë ndahet në disa zona: zona e përhapjes së shkëmbinjve të shkëmbinjve të shkëmbinjve poroze, e shkëmbinjve karbonatikë, e shkëmbinjve molasikë, e shkëmbinjve magmatikë, e shkëmbinjve flishiodal dhe flishore shkëmbinjve metamorfikë dhe të shkëmbinjve evaporite. Për shkak të relievit të larmishëm që ndodhet në territorin e Bashkisë Shkodër, kemi shpërhapjen e shkëmbinjve me veti të mira kolektore (zhavorrë, gelqerorë), si dhe shkëmbinj pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh (argjila, flish, gipse). Bazuar në të dhënat e Hartës Hidrogeologjike të Shqipërisë kemi disa lloje akuiferësh prezent në zonë: 1. Me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri shumë të lartë-të lartë (rërë+zhavorr, rërë+zhavorr+surargjila). Këto lloje shkëmbinjsh janë të shpërhapur kryesisht në pjesën perëndimore të territorit të Bashkisë. Veçanërisht në zonën pranë liqenit si dhe në zonat përgjatë shtetërve të lumenjve. Rezervat ujore që ndodhen në këto lloje 53 shkëmbinjsh, kanë rëndësi të madhe pasi shërbejnë edhe për furnizimin me ujë të qendrave të banimit, për industri dhe për ujë. 2. Me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri mesatare- të ulët (argjila+rërë+surargjila). Këto lloje shkëmbinjsh kanë një përhapje të kufizuar në territorin e Bashkisë. Gjenden kryesisht pranë zonave bregdetare dhe liqenore. Përfaqësohen me depozitimet proluviale të konuseve të derdhjes dhe nga koluvionet shpatore me çimentim të dobët. 3. Me porozitet çarje-karst dhe ujëpërcjellshmëri tepër të ndryshueshme, shumë e lartëshumë e ulët (gëlqeror, dolomite). Shpërhapja e tyre është në të gjithë territorin e Bashkisë, megjithatë më e theksuar bëhet në pjesën veriore të saj. Ujërat karstike shfrytëzohen kryesisht me anën e burimeve. Në pjesët e zbuluara të gëlqerorëve karstike ujërat nëntokësorë kanë një cilësi të mië, janë të ëmbël me një mineralizim të përgjithshëm 0.2-0.4 g/l. Në pjesët ku këto ujëra ndodhen më në thellësi dhe janë të mbuluar nga depozitime flishore dhe molasike, shpesh janë termominerale të ngopura me H₂S. 4. Me porozitet çarjesh dhe ujëpërcjellshmëri të ndryshueshme, mesatare-e ulët. (shkëmbinj magmatikë, metamorfikë). Shpërhapja e tyre është shumë e vogël në territorin e Bashkisë. Këto lloj shkëmbinjsh janë të varfër në ujëra nëntokësorë. Në çarjet e këtyre shkëmbinjve dalin burime me prurje shumë të vogël 0.01-0.06 l/s. Gjithashtu nga harta hidrogeologjike vihet re që të shpërhapur në territorin e Bashkisë ka edhe jo akuiferë: 1- Shkëmbinj pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh (argjila, flish, gipse). Këto lloje shkëmbinjsh janë të përhapur në të gjithë territorin e Bashkisë, veçanërisht në pjesën veri-lindore. Burimet që dalin nga këto lloje shkëmbinjsh kanë prurje të vogël, 0.01-0.1 l/s, për shkak se kanë çarshmëri dhe porozitet të ulët si dhe shkallë të lartë çimentimi. Pjesa më e madhe e burimeve që gjenden në zonë janë të vegjël (1-10 l/s) dhe mesatarë (10- 100 l/s), megjithatë në disa zona të caktuara, veçanërisht aty ku akuiferët janë poroz dhe kanë ujëpërcjellshmëri të lartë vihet re prezenca e burimeve të mëdhenj me prurje mesatare 100- 1000 l/s. Akuiferët me porozitet ndërkokrrizore dhe karstikë vlerësohen me ujëmbajtje shumë të lartë-të lartë, dhe paraqesin rëndësi të madhe në furnizimin e qendrave të mëdha të banuara me ujë të pijshëm. Qyteti i Shkodrës furnizohet me ujë nga zona ujëmbajtëse e Dobracit: • Në Dobrac shfrytëzohen me puse shpimi një sasi uji me prurje totale 1000-1100 l/sek. Shpime të tjera që shfrytëzohen për furnizimin e fshatrave me ujë si më poshtë: • Stacioni i pompimit të Bërdicës (100 l/sek, 2 – shpime). • Stacioni i pompimit të Bushatit (Q = 2 l/sek). • Stacioni i pompimit të Bahçallëkut (Q = 100 l/sek). • Stacioni i pompimit të Dajçit (Q = 11 l/sek). • Stacioni i pompimit të Oblikës (Q = 2 l/sek). • Shpime të tjerë (Q = 80-100 l/sek). Sasia e përgjithëshme e ujit që shfrytëzohet nga pellgu i Shkodrës është rreth 1200-1300l/s. Koeficienti I shfrytëzimit të pellgut kuaternar varion K = 0.33-0.5 Nga të dhënat e studimeve të mëparshme të relacioneve janë matur debitet e puseve. Nga këto studime rezulton se nga shpimet me vetëderdhje dhe

me stacione pompimi të veçanta 54 apo ujësjellësa, merren nga fusha e NënShkodrës afërsisht 1000 lit/sek. Këtu përfshihen edhe burimet në zonën e studimit, që dalin nga gëlqerorët që janë të lidhura me reshjet atmosferike, kurse nga zona e Zadrimës merren afërsisht 300l/s me gjithë burimet për rreth. Nga kjo sasi uji që merret hyjnë: • Q = 100 lit/sek që merren nga stacionet e pompimit të zonës NënShkodrës, • Q=300l/s merren nga privati me puse shpimi dhe puse fshati edhe për vaditje, • Q = 50 l/s merren nga burimet. • Gjithsej: Q = 450 lit/sek. Nga këto studime rezulton se nga shpimet me vetderdhje dhe me stacione pompimi të veçanta apo ujësjellësa, merren nga fusha e NënShkodrës afërsisht 900-100it/sek. Këtu përfshihen edhe burimet në zonën e studimit, që dalin nga gëlqerorët që janë të lidhura me reshjet atmosferike, kurse nga zona e Zadrimës merren afërsisht 300l/s me gjithë burimet për rreth. Nga kjo sasi uji që merret hyjnë: • Q = 100 lit/sek që merren nga stacionet e pompimit të zonës NënShkodrës, disa prej tyre sot nuk punojnë. Q=300l/s merren nga privati me puse shpimi dhe puse fshati edhe për vaditje. • Q = 50 l/s merren nga burimet. • Gjithsej: Q = 450 lit/sek. Resurset dinamike të ujërave nëntokësore Në shfrytëzimin racional të çdo pellgu ujëmbajtës, sidomos për perspektivën ku pritët marrja e sasive më të mëdha uji, rëndësi merr vlerësimi i resurseve, resurset dinamike (Qdin) , që kalon në prerjen tërthore të rrjedhjes në njësinë e kohës. Mbi bazën e krahasimit të tyre përcaktohet dhe bilanci uJOR i shtresës ujëmbajtëse të zhavorëve. Resurset e shfrytëzueshme të ujërave në Pellgun e Shkodrës. Ujërat nëntokësore të zhavorëve ujëmbajtëse në pellgun e Shkodrës janë kapur me një numur të madh shpimesh. Sikurse e kemi përmendur edhe më sipër shpimet shfrytëzojnë horizontin e zhavorëve, që përmbajnë ujëra të ëmbla të pijshëm. 1. Zona e Liqenit të Shkodrës , Dobraç e Lindje, zona e ish ndërmarrjes zooteknike, si edhe zonat e tjera më në lindje e aftësisë ujëdhënëse (gjithmonë me shpime) merren nga 80-100 l/sek në zonën e Dobraçit deri në 10-15 l/sek më në lindje. Në veri të Dobraçit duke u spostuar më në lindje për shkak të trashësisë së reduktuar (prerje efektive më e vogël) debitet janë mbi 5 l/sek, Dragoç, Vrakë, Gril, Grunjë e më në Veri. 2. Zona tjetër me perspektivë është pa dyshim kontakti i karbonateve me depozitimet e kuaternarit në gjithë gjatësinë Shkodër- Demiraj, ku karbonatet shkarkojnë me intensitet për shkak të nivelit më të ulët të këtij kontakti në raport me nivelin e ujërave nëntokësore të zhavorëve. Rrjedhja e ujërave nëntokësore (Resurset Dinamike) Rrjedhja e ujërave nëntokësore ose resurset dinamike formohet për llogari të rrjedhjes së ujërave nëntokësore të infiltruar nga karbonatet që qarkojnë gjithë krahun lindor të Pellgut Shkodër. Për llogaritjen e resurseve dinamike kemi llogaritur sipërfaqen mesatare tërthore të zhavorëve e cila rezulton rreth 572500 m². Koeficientin mesatar të filtrimit m/ditë, që në pusët e Dobraçit rezulton rreth 150 m/ditë si dhe gradient hidraulik që rezulton në vlerën 0.005 m/m. Gjithë kjo sasi uji kuptohet se vjen nga infiltrimi i ujit nga karbonatet në zhavorret e kuaternarit në gjithë gjatësinë e kontaktit të këtyre formacioneve. Nga përlllogaritjet e pellgut ujëndarës të tyre e cila rezulton një sipërfaqe rreth 270 x 10⁶ m³ Koeficientin e infiltrimit të rreshjeve në gëlqeror që pranohet rreth 0.6, rezulton që nga 2000 m/m shi në vit filtrojnë në gëlqeror 1200 m/m ose 1.2 m/vit (I). Infiltrimi i dobishëm në gjendje ekuilibri të bilancit, sasia e ujit që infiltron në masiv (Ië) rezulton: Ië= S x I = 270 x 10⁶ x 1.2 m/dite = 7.13 m³/sek ose 7130 l/sek Nga sa shihet nga përlllogaritjet, sasia e ujit që futet në zhavorret e kuaternarit me atë që del dhe shkarkon në liqen është afërsisht e barabartë ose më saktë rreth 1000 l/sek më shumë. 55 Nga pellgu ujëmbajtës sot për sot merren rreth 1100 l/sek (ujësjellësi Shkodër + Komunat në këtë pellg). Nga sa shikohet sot për sot shfrytëzohen rreth 18-20 % e aftësisë rrjedhëse të pellgut. Sasia e ujit që shkarkohet nga gëlqerorët duhet marrë me rezervë për faktin se kërkon studime e llogari më të sakta sepse ajo përbën rreth 2 % të sasisë që shkarkon Buna nga liqeni (320 m³/sek). Në këto kushte kuptohet që infiltrimi në gëlqeror mund të jetë me i madh por mungesa e studimeve në këtë drejtim nuk lejon të bëhen llogari të sakta. Në përgjithësi, nga sa shihet, kapaciteti ujëdhënës i pellgut nuk mund të jetë më i madh se 6 m³/sek. Në rast se do të rrisnim këto sasi uji në shfrytëzim do të ndodhte devijim i rrjedhjes së ujërave nga drejtimi i tanishëm PL në drejtimin LP (Liqeni – Zhavore të pellgut, një fenomen tepër i dëmshëm. Kështu duke patur parasysh faktorët e mësipërm ne do të rekomandonim shfrytëzimin e jo më shumë se 70 % të resurseve dinamike ose 4.2 m³/sek. Resurset dinamike për fushën NënShkodër-Zadrimë janë për llogari të infiltrimit të ujit nga lumi Drin dhe Buna me një front ushqimi prej 20 km, trashësi të shtresës së zhavorëve prej 10-60 m, K=100-150 m/ditë dhe i = 0.002 rryma nëntokësore natyrore (Që) e përcaktuar me formulën Darsi dhe rezultojnë rreth 600l/s në pjesën e profilit të paraqitur në bregun e Bunës dhe 400l/s për bregun e lumit Drin, pra rreth 1000 l/s. Erozioni detar Kjo dukuri është më aktive përgjatë derdhjes së lumit Buna. Ndërkohë që në zonën e Bunës deti ka përparuar 500 m në brendësi të tokës. Sipas disa vërtetimeve të specialistëve, një ndër shkaqet kryesore për përparimin e bregdetit është bllokimi i aluvioneve, që llogariten 13 herë më pak krahasuar me ato të vitit 1854, kur lumi u nda në dy degë (njëra u bashkua me Lumin Buna, 1,5 km poshtë Liqenit të Shkodrës dhe dega tjetër që vinte poshtë në Lezhë tashmë është kthyer në kanal). Një ndikim të madh në këtë fenomen kanë luajtur dhe veprat e mëdha hidroteknike mbi lumin Drin, të ndërtuara pas vitit 1963. Shqipëria dallohet për një rrjet hidrografik të pasur dhe vet bashkia Shkodër ka një shumëllojshmëri elementësh uJOR të përbërë nga përrenj, lumenj, burime, liqene, si dhe ujërat e detit Adriatik. Elementët e rinj hidrografik janë dhe ujëmbledhësit artificial të shumtë në numër si dhe sistemi i gjerë i kanaleve kulluese e ujitëse. Ky rrjet hidrografik përveç vlerave natyrore dhe estetike të

peisazhit ka dhe rëndësi ekonomike e jetësore. Elementet ujore më të rëndësishëm në këtë territor janë: liqeni i Shkodrës, lumi Drin, lumi Buna, lumi Kir, lumi Shalë laguna e Vilumit, kënetat e Domnit etj.

*Peisazhi, topografia dhe mbulesa e tokës

Shkodra ndodhet në veri-perëndim të Shqipërisë. Koordinatat gjeografike janë: Gjerësi 19°30'42", gjatësi 45°03'05". Bashkia e re Shkodër ka një larmishmëri relievi si rrjedhojë e zgjerimit të saj nga perëndimi në drejtim të Velipojës dhe nga Veri-lindja në drejtim të Alpeve. Qyteti është i vendosur kryesisht në rrafshinë. Në drejtimin jug-perëndim veri-lindje ka kuotat nga 9.5 m deri në 24 m mbi nivelin e detit. Gjeologjikisht qyteti ndodhet në rajonin e një fundosje tektonike të periudhës së pliocenit. Në truallin e qytetit gjenden depozitimet e lumenjve përreth. Klima është mesdhetare me një përzierje kontinentale dhe detare. Në veriperëndim të tij ndodhet Liqeni i Shkodrës. Nga liqeni buron Lumi i Bunës (44 km) që derdhet në detin Adriatik. Rrjedhja e poshtme e lumit Buna ndan kufirin me Malin e Zi. Lumi Bunës bashkohet me lumin Drin rreth 2 km në jugperëndim të qytetit. Nga ana lindore qyteti kufizohet nga Lumi i Kirit që buron nga Malësitë e Veriut dhe është 43 km i gjatë. Ky lum derdhet në Lumin Drin që rrethon Shkodrën nga ana jugore. Pjesa kryesore fushore e qytetit ka një shtrirje prej 1,150 ha, ndërsa pjesa kodrinore ka një shtrirje prej 350 ha. Në qytet përfshihen dhe tre lagje periferike: Bahçalleku në jug, Shiroka dhe Zogaj në perëndim, të cilat zënë gjithsej një sipërfaqe prej 180 ha. Shkodra nga ana lindore dhe jugore rrethohet nga një varg kodrash deri në 110 m lartësi, kodrat e Rrencit në lindje dhe të Tepes në jug. Në jugperëndim gjendet kodra shkëmbore e kalasë së Rozafës me lartësi 130 m dhe sipërfaqe 3.6 ha. Nga veriu dhe veri-perëndimi shtrihet Fusha e Mbishkodrës përtej të cilës fillojnë Alpet e Shqipërisë. Rreth 30 km në juglindje ndodhet bregdeti Adriatik me Plazhin e Velipojës. Siç shihet brenda një rreze prej 30 km, me qendër Qytetin e Shkodrës, ekziston një tërësi bukurish natyrore, nga malet e larta Shqiptare deri tek bregdeti mesdhetar i Adriatikut, nga brigjet e liqenit më të madh në Ballkan tek kodra shkëmbore e kështjellës së Rozafës, e cila qëndron madhërisht mbi një qytet i cili para 100 vjetësh kishte një lum të lundrueshëm duke sjellë anije tregtare dhe pasagjere në gjirin e saj. Shkodrës i takojnë 13 maja në Alpe, që i kapërcejnë të 2000m lartësi si: Jezerca (2694m), Papluka, Mali i Vilës, Radohima (2570m), Mali i Shënikut (2550m) si dhe Biga e Gimajve (mbi 2200m) etj. Krahas këtyre majave në Shkodër gjenden male të tjera më të ulëta si Taraboshi (595m), Shita e Hajmelit e deri te kodrat e Bushatit, të Bërdicës, të Kodhelit, të Kakarriqit, të Rrencit e të Tepes. Ndër luginat më të bukura në rrethin e Shkodrës është lugina e Shalës (e përbërë nga dy lugina të vogla: lugina e Kopreut dhe lugina e Thethit), lugina e Kirit dhe lugina e Përroit të Thatë.

*Mbulimi i tokës dhe qellimi i saj

Zona është në përgjithësi e mbuluar nga barishte. Zona në vlerësim vlerësohet si tokë e llojit are ku sot nuk është e shfrytëzuar për qellime bujqësore apo blektorale, është një përfaqje tokë me pamje të thjeshtë dhe me pamje nga rruga internacionale.

*Mjedisi biologjik në zonën e studimit

Zona e projektit ka një larmishmëri mesatare të habitatit shtazor. Disa specie të vezhguara në zonë janë gjarperinjte, zogj, gjitarë të vegjël dhe amfibe.

Ndërsa në lidhje me bimesinë e saj vlerësohet për prani të shkurreve mesdhetare dhe barishte, të cilat nuk klasifikohen në Listen e Kuqe si bimë të rrezikuara.

*Zonat e ndjeshme mjedisore dhe ndikimi nderkufitar

Zona në vlerësim nuk klasifikohet në listen e zonave me status të vëncante, është një zonë e zakonshme rurale e kufizuar nga një kanal kullimi dhe ndodhet pranë rrugës internacionale. Nuk është zonë nderkufitare prandaj nuk ka ndikim nderkufitar në mjedis.

*Zhurmat

